



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 12/19), neni 40 paragrafi 2 i Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar në rastin e formuar pas kërkesës së paraqitur nga parashtruesi i njohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme KSHPK), në seancën e 82-të të mbajtur më 14.02.2023 ka miratuar si në vijim.

VENDIM

Kërkesa përfaqëson në fakt një kërkesë drejtuar KSHPK-së në lidhje me marrjen e vendimit se shitja në fjalë nuk përbën shkelje të nenit 8-a të Kodit Zgjedhor, sipas të cilit KSHPK-ja konstatoi se nuk ka elemente për veprim kompetent.

Lënda me numër 12 – 2684/1 të datës 13.05.2019, të mbillet dhe të arkivohet.

Ky vendim në formë të depersonalizuar të publikohet në veb faqen e KSHPK-së në afat kohor prej 5 (pes) ditëve nga dita e miratimit.

Arsyetim

Nga një parashtrues i njohur më datë 13.05.2019, është dorëzuar denoncim me pretendime kundër kundër Agjencisë për Rezerva Mallrash për veprim në kundërshtim me nenin 8-a të Kodit Zgjedhor dhe është formuar lënda numër 12-2684/1, datë 13.05.2019.

Në denoncim, parashtruesi i kërkesës thekson se me datën 07.03.2019 Agjencia për Rezerva Mallrash ka publikuar shpalljen nr. 1/19 për shitjen e grurit nga rezervat e mallrave të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në kundërshtim me njoftimin e KSHPK-së për veprimet e ndaluara të institucioneve shtetërore nga dita e marrjes së vendimit për shpalljen e zgjedhjeve deri në përfundimin e zgjedhjeve.

Parashtruesi ka marrë pjesë në shpalljen e publikuar, ku ka dorëzuar aplikim dhe garanci bankare për pjesëmarrje në ankand publik, ku është përzgjedhur si ofertuesi më i favorshëm. Nga Agjencia ka marrë vendim dhe zgjidhje me afat pagese për mjetet financiare. Për shkak të njoftimit publik në media se është përzgjedhur si ofertuesi më i favorshëm, aplikanti është dëmtuar në atë mënyrë që Administrata e të Ardhurave Publike ka kryer një kontroll të veprimtarisë së tij, për shkak të së cilës ai nuk ka mundur të paguajë fondet brenda afatit të caktuar, për shkak të të cilit kërkoi zgjatjen e tij. Për shkak të mos respektimit të afatit, Agjencia ka aktivizuar garancinë bankare. Nga KSHPK-ja si autoritet i vetëm kompetent për miratimin e procedurave të prokurimit dhe shitjes gjatë periudhës zgjedhore, i kërkohet të raportojë nëse procedura përbën shkelje të Kodit Zgjedhor.

Pas shqyrtimit të pretendimeve në fjalë, KSHPK-ja konstatoi se as Kodi Zgjedhor dhe as Ligji për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit nuk e parashikojnë këtë kompetencë të KSK-së, prandaj vendosi si në dispozitiv të Vendimit.

Duke marrë parasysh sa më sipër, KSHPK-ja vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Dorëzuar:

- parashtruesi i denoncimit

Përgatiti: B.M.J.

Miratoi: K.N., Anëtar i KSHPK--së

**KOMISIONI SHKETËRORË
PËR PARANDALIMIN E
KORRUPSIONIT
Nënkryetar
Katica Nikolovska**

